



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 1589 Prot.

Lezhë, më 02 . 02 . 2026

VENDIM

Nr. 11, Datë 28. 01. 2026

**PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË SHPENZIMEVE PËR PRITJE E
PËRCJELLJE ZYRTARE PËR VITIN 2026**

Në mbështetje nenit 8 dhe 25, të Ligjit Nr. 139/ 2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar , Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 258, datë 3.6.1999 “Për një ndryshim në VKM-në Nr.243, datë 15.05.1995 “Për shpenzimet për pritjen, përcjelljen dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja”, shkresës Nr.939 Prot., datë 22.01.2026 të Drejtorisë së Kulturës dhe Trashëgimisë Kulturore dhe shkresës Nr. 940 Prot., datë 22.01.2026 të Drejtorisë së Turizmit, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë,

Vendosi:

- 1- Miratimin e programit të shpenzimeve për pritje e përcjellje zyrtare për vitin 2026 sipas listës së aktiviteteve bashkëlidhur këtij vendimi.
- 2- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Lezhë.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 , të ligjit nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore “ të ndryshuar .

**SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ**

**KRYETARI
NDUE LULI**





PROGRAM PËR ZHVILLIMIN E AKTIVITETEVE PËR PRITJE E PËRCJELLJE ZYRTARE PËR VITIN 2026

1. Data 1 Mars- Dita e Arbëreshëve

Ky aktivitet është konceptuar me pjesëmarrjen e Presidentit, Delegacioneve Qeveritare, Deputetëve, Ministrave dhe personaliteteve të vendeve nga komunitetet Arbëreshe në Italinë e Jugut (Sicili, Kalabri, Pulia dhe Basilikata). Pjesëmarrës në delegacion mund të jenë 100 persona për akomodim.

2. Data 2 Mars – 582 Vjetori i Kuvendit të Lezhës

Eventi tematiko - artistik i 2 marsit, “Kuvendit të Lezhës” është konceptuar zhvillim i një aktiviteti të madh me pjesëmarrje të Kryetarëve të Bashkive dhe Komunave të Kosovës, Maqedonisë së Veriut, Malit të Zi e më gjerë. Zyrtarë të lartë institucionesh dhe personalitete në fusha të ndryshme. Pjesëmarrës në delegacion parashikohet të jenë 100 persona.

3. Aktiviteti Çmimet Letrare “At Zef Pllumi” Mars -Prill 2026

Çmimet Letrare “At Zef Pllumi”, aktivitet që prej vitesh bashkon krijues nga mbarë hapësira shqipfolëse.. Pjesëmarrës në këtë aktivitet parashikohet të jene: Ministri I Pushtetit Vendor, Deputetët, Titullar Institucionesh Vendore dhe Personalitete të shquara të artit dhe kulturës. nga Kosova dhe Maqedonia e Veriut.

4. Hapja E Sezonit Turistik Veror - Maj 2026

Aktivitetet e organizuara me këtë rast synojnë për të tërhequr vëmendjen e turistëve për zonat bregdetare të Lezhës.

Në këtë aktivitet marrin pjesë përfaqësues nga institucionet më të rëndësishme të Shqipërisë, Kosovës si dhe trevave të tjera shqipfolëse si: Kryetarët e Komunave të Republikës së Kosovës, Ministrat e Trevave Shqiptare, Delegacione që përfaqësojnë institucione të ndryshme dhe personalitete të fushave të ndryshme të Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë së Veriut dhe më gjerë.

5. Ditët E Shtegtarëve- Gusht 2026

Ditët e Shtegtarit ka për qëllim të argëtojë dhe të relaksojë komunitetin dhe të krijojë atmosferë festive dhe mikpritëse për emigrantët dhe turistët që vizitojnë qytetin tonë. Festa e Shtegtarit është një festë e përvitshme që organizohet në Lezhë, ku marrin pjese rreth 12 000 vizitorë, turistë dhe emigrantë të kthyer pranë familjeve të tyre. Gjatë kësaj feste, sheshi “Gjergj Kastrioti”

në Lezhë, bëhet një prej zonave më e frekuentuar dhe në këtë mënyrë gjallërohet jeta në qytet si dhe prezantohet kultura lezhjane dhe ajo Shqiptare në përgjithësi. Në këtë aktivitet marrin pjesë Titullarë institucionesh qendrore dhe lokale ,shoqata kulturore si dhe emigrante sipërmarrës në karrierë.

6. Festivali Tipologjik Shtator -Tetor 2026

Ky festival organizohet nga Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale, në bashkëpunim me Bashkinë e Lezhës, duke treguar angazhimin për promovimin e vlerave të trashëgimisë folklorike shqiptare. Pjesëmarrësit janë delegacione dhe grupe artistike nga trevat e ndryshme të Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë së Veriut dhe më gjerë.

7. Aktiviteti Çmimet Letrare “At Gjergj Fishta” Tetor 2026

Çmimet Letrare “At Gjergj Fishta”, aktivitet që bashkon krijues nga mbarë hapësira shqipfolëse. Pjesëmarrës në këtë aktivitet parashikohet të jenë, Ministri I Pushtetit Vendor , Deputetët e qarkut Lezhë, Titullar Institucionesh Vendore dhe Personalitete të shquara të artit dhe kulturës nga Kosova dhe Maqedonia e Veriut..

8. Pritjet Zyrtare- Gjatë vitit 2026

Delegacione të ndryshme gjatë vitit për binjakëzime, marrëveshje bashkëpunimi, shkëmbim eksperiencash intitucionale ndërmjet Bashkisë Lezhë dhe institucioneve të tjera ndërkombëtare. Pjesëmarrës në këto delegacione parashikohet të jenë Presidentë, Ambasadorë, Kryetarë të Bashkive dhe Personalitete të fushave të ndryshme.

Nr. 1559/, Prot
Dt. 9-2-26



K.B

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË

SEKTORI JURIDIK

Nr. 117/16 Prot.

Lezhë, më 09.02. 2026

Lënda: Konfirmim vendimi.

KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË

Për dijeni: **KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË**

Bazuar në nenin 16 pika 2 gërma "b" të ligjit Nr.107/2016 datë 27.10.2016 "Për prefektin e qarkut, *i ndryshuar* nenin 54, të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" *i ndryshuar*; konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit nr.11 datë 28.01.2026 të Këshillit të Bashkisë Lezhë "Për miratimin e programit të shpenzimeve për pritje e përcjellje zyrtare për vitin 2026".

PREFEKTI

Taulant MALSHI

